

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I HISTORISË

EDMOND MALAJ

**PROFILE QYTETESH
DHE LOKALITETESH MESJETARE
TË ARBËRISË VERIORE**

Studime për Mesjetën

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA

Përmabajta	III
Lista e shkurtimeve	VII
Parathënie	1
Disa aspekte nga ekonomia e Shkodrës mesjetare	5
Llojet e parave	9
Tregtia	20
Peshkimi	23
Prodhimi i verës dhe pijetoret	28
Ullishtet dhe vaji i ullirit	31
Pronat e tokave të bashkisë	32
Zejet	33
Doganat dhe vendkalimet e ndryshme	37
Drishti në mesjetë	43
Pozicioni gjeografik	44
Të dhëna historike	47
Bashkësia e qytetit	58
Përmbledhje	67
Dëja dhe Sarda në Mesjetë	71
Qyteti mesjetar i Dëjës	72
Qyteti i Sardës dhe ipeshkvia e saj	79
Sarda si qendër kishtarë dhe ipeshkvi	86
Vargu i ipeshkëve të Sardës deri në 1521	89
Edhe një herë rreth Dëjës në Mesjetë	97
Mbi historinë e Dëjës	98
Baleci në Mesjetë	117
Të dhëna rreth qytetit	119

Të dhëna për Hotin në Mesjetë	133
(Me disa të dhëna edhe për periudhën e pushtimit osman)	133
I. Periudha mesjetare	133
II. Koha e perandorisë osmane	151
Një pemë gjenealogjike e fiseve të Hotit	159
Lezha gjatë periudhës së Arntikitetit	161
Hyrje	161
Zanafillat	166
Lisus gjatë luftërave iliro-romake	173
Pushtimi nga Filipi V i maqedonasve	175
Nën sundimin e mbretit ilir Gent	179
Nën sundimin romak	181
Lezha në Mesjetë	193
Mesjeta e Hershme. Periudha e parë bizantine	194
Nën temën e Durrësit. Periudha e dytë bizantine	199
Periudha serbe	200
Blinishtët	203
Nën sundimin e Balshajve	205
Si rezidencë e Dukagjinëve	206
Periudha Venedikase	208
Lezha dhe Skënderbeu	214
Pushtimi osman	223
Ekspedita e Gjon Kastriotit	225
Lezha dhe ekspedita e Skënderbeut të Ri	227
Disa aspekte nga pushtimi i Shkodrës dhe i qendrave përreth saj nga osmanët në fundin e shekullit XV	235
Rrethimi i parë i Shkodrës nga osmanët	236
Pushtimi dhe shkatërrimi i Dëjës	241
Rrethimi i dytë i Shkodrës dhe pushtimi	241
Pushtimi i Drishtit	253
Pushtimi i Lezhës	260
Shasi	262

Të dhëna për Hotin në Mesjetë	133
(Me disa të dhëna edhe për periudhën e pushtimit osman)	133
I. Periudha mesjetare	133
II. Koha e perandorisë osmane	151
Një pemë gjenealogjike e fiseve të Hotit	159
Lezha gjatë periudhës së Arntikitetit	161
Hyrje	161
Zanafillat	166
Lisus gjatë luftërave iliro-romake	173
Pushtimi nga Filipi V i maqedonasve	175
Nën sundimin e mbretit ilir Gent	179
Nën sundimin romak	181
Lezha në Mesjetë	193
Mesjeta e Hershme. Periudha e parë bizantine	194
Nën temën e Durrësit. Periudha e dytë bizantine	199
Periudha serbe	200
Blinishtët	203
Nën sundimin e Balshajve	205
Si rezidencë e Dukagjinëve	206
Periudha Venedikase	208
Lezha dhe Skënderbeu	214
Pushtimi osman	223
Ekspedita e Gjon Kastriotit	225
Lezha dhe ekspedita e Skënderbeut të Ri	227
Disa aspekte nga pushtimi i Shkodrës dhe i qendrave përreth saj nga osmanët në fundin e shekullit XV	235
Rrethimi i parë i Shkodrës nga osmanët	236
Pushtimi dhe shkatërrimi i Dëjës	241
Rrethimi i dytë i Shkodrës dhe pushtimi	241
Pushtimi i Drishtit	253
Pushtimi i Lezhës	260
Shasi	262

PARATHËNIE

Në këtë vëllim është mbledhur së bashku një numër i përzgjedhur artikujsh të botuar në një rrjedhë kohore prej dhjetë vitesh nga hulumtimet të mia mbi historinë mesjetare të trojeve shqiptare. Materiali i këtij vëllimi hedh dritë kryesisht mbi historinë e disa qyteteve dhe lokaliteteve në Arbërinë veriore, duke u përqendruar kryesisht në krahinën e Shkodrës. Në këtë vëllim nuk kemi paraqitur të dhëna rreth historisë kishtarë të këtyre qyteteve, pasi me to jemi marrë tashmë në një vëllim me titull "*Hulumtime mbi historinë e Krishterimin në Shkodër e rrethina gjatë Mesjetës*"¹ që kemi botuar jo shumë kohë më parë. Si metoda hulumtimi kemi përdorur qoftë metodën tematike qoftë atë kronologjike duke u mbështetur në punime të botuara dhe në dokumente, të cilat në këtë punim zënë një vend kryesor. Vëllimi është i ndarë në dymbëdhjetë kapituj, të cilët janë si njësi më vete, por që të gjitha së bashku japin një pasqyrë historike të Arbërisë veriore, duke u përqendruar kryesisht tek qytetet.

Në kapitullin e parë me titull "*Disa aspekte nga ekonomia e Shkodrës mesjetare*" paraqitet një pasqyrë e përgjithshme e ekonomisë së Shkodrës gjatë Mesjetës, e ndarë sipas zërave të ndryshëm, duke ia nisur nga sistemi monetar i përdorur gjatë asaj periudhe e duke përfunduar me doganat në lidhje me produktet dhe me pikat e ndryshme doganore, ku hynin e dilnin mallrat e ku vilesnin taksat. Një vëmendje të veçantë u kemi kushtuar zejeve të ndryshme dhe prodhimeve të tyre në

¹ Edmond Malaj, *Hulumtime mbi historinë e Krishterimin në Shkodër e rrethina gjatë Mesjetës*. Shkodër: Botime Françeskane 2021.

Shkodër, të cilat i kemi rënditur në mënyrë sistematike, duke u bazuar kryesisht tek *Statutet e qytetit të Shkodrës*, por edhe në dokumente të tjera.

Në kapitullin e dytë kemi venë Drishtin, si qytetin më të madh e më me rëndësi në rrethinat e Shkodrës. Për këtë qytet kemi dhënë detaje të përgjithshme qoftë në lidhje me historinë e qytetit, qoftë në lidhje me bashkësinë e më administratën. Me historinë e Ipeshkëvisë dhe të Kishës së Drishtit nuk jemi marrë në këtë vëllim, pasi tashmë kemi shkruar në mënyrë të detajuar për këto çështje në monografinë "*Drishti, Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*"², por edhe në vëllimin tonë të sipërpërmendur "*Hulumtime mbi historinë e Krishterimin në Shkodër e rrethina gjatë Mesjetës*"³.

Në kapitujt III, IV dhe V në qendër të hulumtimit janë dy qytetet mesjetare Dëjë (Dagno) dhe Sardë që në gjuhën shqipe njihet edhe me emrin Shurdhah. Këto dy qendra, përveçse ishin qendra ipeshkvnore kishin edhe një zhvillim zejtar, ekonomik, kulturor. Për Sardën kemi dhënë edhe informacione përmbledhëse edhe në lidhje me ipeshkvinë e ktij qyteti. Për nxjerrjen e këtyre të dhënave jam përqendruar kryesisht tek *Vepra monumentale* e Daniele Farlato-s dhe Jakob Koletos "*Illyricum Sacrum VII*". Në kapitullin V, i kemi kushtuar sërish një hapësirë qytetit të Dëjës. Aty historia e saj paraqitet më e zgjeruar me të dhëna të reja dokumentare.

² Edmond Malaj, *Drishiti. Historia edhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2016. Pjesa e dytë (faqet 285-382) e kësaj monografie që i kushtohet tërësisht Ipeshkëvisë dhe Kishës së Drishtit

³ Për Ipeshkvinë e Drishtit dhe klerikët e saj shih tek: E. Malaj, *Hulumtime ...*, f. 109-169.

Kapitulli VI i kushtohet qytetit të vogël të Balcit, i cili ka ekzistuar si qytet kryesisht në Mesjetën e mesme. Aty jepen vetëm të dhëna që kanë të bëjnë me historinë e përgjithshme të tij. Të dhënat rreth ipeshkëvisë së Balcit nuk janë të përfshira në këtë vëllim, pasi për to kemi shkruar tashmë edhe në vëllimin e sipërpërmendur.⁴ Ndërsa në kapitullin VIII kemi disa rezultate nga hulumtimet për krahinën e Hotit gjatë mesjetës dhe gjatë periudhës së sundimit osmanë.

Kapitujt VIII dhe IX merren me historinë e Lezhës nga antikiteti deri në fund të Mesjetës. Tek kapitulli që merret me periudhën e Mesjetës, kemi paraqitur edhe të dhëna rreth marrëdhënieve të këtij qyteti me Skënderbeun dhe rreth kryengritjeve që ndodhën më vonë të organizuara nga i biri i Skënderbeut, Gjon Kastrioti dhe nga nipit i tij Gjergj Kastrioti, i ashtuquajturit Skënderbeu i ri. Këto kryengritje plasën në një kohë kur tashmë qyteti ndodhej në duart e osmanëve.

Në Mesjetë arbërorët kanë pasur gjithashtu diasporën e tyre, e cila ishte e vendosur kryesisht në Gadishullin Apenin (sidomos në Venedik), por edhe në Dalmaci. Në kapitullin IX i kushtohet një hapësirë arbërorëve që jetonin në Republikën e Raguzës. Ata i kemi ndarë sipas profesionit të tyre dhe u kemi kushtuar një vëmendje të veçantë sidomos aktivitetit të tyre zejtar.

Kapitulli X merret me pushtimin e Shkodrës dhe të qyteteve e lokaliteteve që ndodheshin përreth saj. Pra në këtë pjesë të vëllimit jemi orvatur që të paraqesim jo vetëm pushtimin faktik, por edhe disa aspekte të perëndimit të qytetërimit shqiptar mesjetar të shkaktuar nga pushtimi osman,

⁴ Për të dhëna rreth Ipeshkëvisë së Balcit shih: E. Malaj, *Hulumtime ...*, f. 170-182.

duke u përqendruar në qytetin e Shkodrës dhe të disa qendrave përreth saj, siç ishin Drishti, Dëja, Lezha e më vonë edhe Tivari e Ulqini, qendra këto që gjendeshin jo shumë larg qytetit të Shkodrës dhe që bënin pjesë në të ashtuquajturën Arbëri Venedike.

Në kapitullin XI e të fundit i kemi kushtuar një hapësirë famullive të Krajës e të Shestanit dhe fshatrave përreth Ulqinit e Tivarit, të cilat banoreshin nga shqiptarë dhe jo vetëm gjatë Mesjetës, por edhe gjatë periudhës osmane e akoma edhe në ditët e sotme. Këto treva sot ndodhen në shtetin e Malit të Zi, por banohen edhe sot e kësaj dite kryesisht nga shqiptarë. Ky kapitull përqendrohet në të dhëna të nxjerra kryesisht nga relacione kishtarë të cilat hedhin dritë jo vetëm mbi gjendjen kishtarë, por edhe mbi atë të popullsisë së këtyre fshatrave dhe lokaliteteve të kësaj treve. Pra përmbajtja e këtij kapitulli ka të bëjë kryesisht me shekujt e parë të pushtimit osman, por nuk mungojnë as të dhëna për periudhën mesjetare. Në këtë kapitull jepen edhe të dhëna dhe foto origjinale të grumbulluara nga vetë autori gjatë dy ekspeditave që ai ndërmori në këto lokalitete në vitet 2011, 2012.

Edmond Malaj
Tiranë, maj 2021